



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.96/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa ZL-Anr.96/2025 e datës 02.10.2025 , e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen më datë 12.10.2025.

A r s y e t i m

Me datë 02.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë në të cilën theksohet se më datë 01.10.2025 rreth orës 14:00 , aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur që në rrugën “ Llola Ribar “ , në Mitrovicën e Veriut është evidentuar vendosja e posterëve zgjedhorë të subjektit politik Lista Serbe në objekte banesore kolektive . Ky veprim përbën shkelje të dispozitave ligjore për fushatën zgjedhore. Tutje parashtruesi i ankesës shton se ky veprim është në kundërshtim me nenin 7 par.2.6 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve , e cila ndalon vendosjen e materialeve zgjedhore në ndërtesa apo objekte banimi përveçse më pëlqimin paraprak të banorëve

dhe kur janë të kontraktuara . Në këtë rast, në bazë të pretendimeve të elaboruara në ankesë dhe duke marrë parasysh shkeljen e rregullave zgjedhore nga ana e Listës Serbe , parashtruesi i ankesës kërkon që PZAP të nxjerrë vendim me të cilin e aprovon këtë ankesë.

Si provë për pretendimet në ankesë, parashtruesi ka bashkangjitur fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit, në kundërshtim me LZP.

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik Lista Serbe theksojnë se ka një mangësi serioze të paraqitjes së ankesës, pasi sipas tyre bëhet fjalë për një fotografi të marrë më shumë se 6 muaj më parë, dhe jo siç pohon Lëvizja Vetëvendosje, tutje shtojnë se në foton e përmendur, me një shqyrtim të kujdesshëm, mund të konstatohet se materiali promovues i paraqitur nga parashtruesi i ankesës ka numrin 112. Ndërsa në këto zgjedhje, Lista Serbe paraqitet me numrin garues 170.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Lista Serbe, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, Paneli duke vepruar konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh “Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshëm.” Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se pretendimet ankimore te subjektit politik LVV se subjekti politik Lista Serbe ka vendosur posterat ne objektin banesor kolektiv janë te pabazuara për faktin se ky subjekt politik ne zgjedhjet lokale bart numrin 170 ndersa posterit ekzistues ne ate objekt banesor kishte numrin 112 qe supozohet te ketë mbetur shume kohe me pare apo nga zjedhje te kaluara, dhe mbi këtë arsye ankesa është e pabazuar. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se

nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk është vërtetuar se ka shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL-Anr.96/2025 datë 03.10.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.